

BASHKIA FIER
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 12 dt. 30.01.2025 “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes “tokë pa frut” ndodhur në fshatin Hasturkas Njësia Administrative Libofshë Bashkia Fier”, Bashkia Fier do të realizojë procedurën për dhënie me qira me konkurim të pronës me nr. pasurie 43/2, zk. 1940 me sipërfaqe 69 000 m², ndodhur në fshatin Hasturkas Njësia Administrative Libofshë, pronë e Bashkisë Fier.

Dhënia me qira e pasurisë jepet me ushtrimin e aktivitetit në fusha të ndryshme sipas përcaktimeve të VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Vlera dysheme për detyrimin e qirasë për fillimin e ankandit do të jetë 27000 lekë ha/vit.

Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie është deri 20 vjet.

Vlerësimi i ofertave të konkurentëve do të bëhet me pikët si vijon:

- | | |
|---|---------|
| a) Niveli i investimit | 10 pikë |
| b) Niveli i punësimit | 10 pikë |
| c) Përvoja në fushën e aktivitetit që do të ushtrohet | 10 pikë |
| d) Oferta e detyrimit mujor të qirasë | 70 pikë |

Konkurimi do të zhvillohet në dt. 10.07.2025 ora 11.00 në Bashkinë Fier sipas procedurave të parashikuara në VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira sipas legjislacionit në fuqi.

Konkurentët do të paraqesin pranë Zyrës së Arkiv/Protokollit në Bashkinë Fier, deri në dt. 10.07.2025 ora 11.00 dokumentacionin si vijon:

- Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksion të objektit, ku të përshkruhen qartë; plani i punësimit, plani i investimeve si dhe treguesit që do të realizohen;
- Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Çertifikatën e rregjistrimit dhe çertifikatën historike të rregjistrimit të subjektit në QKR;
- NUIS – in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.